



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data

Lënda: Mbi disa rekomandime të pjesshme për ndryshime të kuadrit ligjor zgjedhor

Nr. Protokolli

**DREJTUAR: KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE**

KUVENDI

Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, Nr. 4, Tiranë

Të nderuar Anëtarë të Komisionit,

Me interesin e përbashkët institucional për të reformuar kuadrin ligjor zgjedhor duke përmirësuar aspekte të ndryshme rregullatore të zgjedhjeve, lutemi për vëmendjen Tuaj për sa vijon:

Sikurse ju e dini, bazuar në nenet 3, 8 e 10 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore parashikohen të zhvillohen vitin tjetër në një nga datat e periudhës 15 prill – 15 maj. Sipas njoftimeve publike, afati i veprimtarisë së Komisionit Tuaj është deri në muajin mars të vitit 2023. Kjo do të thotë se Komisioni juaj i nderuar do të ketë përfunduar draftin e ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, apo draftin e një Kodi të ri Zgjedhor deri në këtë datë.

Duke llogaritur edhe kohën që duhet për miratimin në seancë publike të këtyre ndryshimeve apo të ligjit të ri zgjedhor, është e qartë që ato nuk do të jenë në fuqi për zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore të vitit 2023.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shprehur interesin për të prezantuar tek ky Komision Parlamentar, mendimet dhe propozimet e veta mbi ndryshime të mundshme të ligjit zgjedhor. Kemi konstatuar se këto kontribute janë të mirëpritura edhe nga vetë ky Komision.

Në këtë kuadër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vlerëson se disa rregulla që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore, mund të rikonsiderohen nga Komisioni juaj në mënyrë pjesore brenda një periudhe 2-3 mujore. Kjo me qëllim që, ndryshimet e mundshme me këtë rast të Kodit Zgjedhor të mund të ishin në fuqi për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2023, pra pa prituri që ndryshimet në ligjin zgjedhor të jenë totale dhe njëherësh.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve rekomandon që të konsiderohen për ndryshime të Kodit Zgjedhor sa vijon:

1) **Mënyra/forma e organizimit dhe e funksionimit të komisioneve të qendrave të votimit (KQV) të komisioneve zonale të administrimit zgjedhor (KZAZ), si dhe e grupeve të numërimit (GN).**

Qëllimi është që të paktën në aspektin formalo-teknik të kemi një administrim më të mirë të procesit zgjedhor nga komisionet e niveleve të dyta dhe të treta.

Përmirësimet që ne nxisim në lidhje me këtë aspekt, jo domosdoshmërisht ato duhet, apo mund t'i zhveshin partitë nga të drejtat që ato kanë sot në administrimin e zgjedhjeve, përfshi këtu edhe të drejtën për vendim-marrjen nga përfaqësuesit e tyre në këto komisione.

Propozimet në lidhje me organizimin dhe funksionimin e këtyre komisioneve vlerësojmë se janë në përputhje edhe me rekomandimin e OSBE/ODIHR nr. 7, viti 2019, si dhe me konstatimet e konfirmuara në Raportin e OSBE/ODIHR për zgjedhjet e 25 Prillit 2021.

2) **Rregullat për financimin e fushatës zgjedhore.**

Financimi i partive politike është një aspekt shumë i rëndësishëm i procesit zgjedhor dhe si i tillë vlerësojmë se ka shumë për të përmirësuar. Duke qenë se koha në dispozicion për zgjedhjet e radhës nuk lejon ndryshime themelore dhe mundësi për zbatimin e tyre, sugjerojmë të konsideroni për momentin rekomandimet vijuese:

- a. Të përcaktohen rregulla për pasqyrimin e fushatës zgjedhore në median në internet (online), në rrjetet sociale dhe në median e shkruar.
- b. Të përcaktohen rregulla në lidhje me financimin dhe fushatën e subjekteve të identifikuar si “palë të treta“.

Propozimet për këtë aspekt vlerësoj se janë në përputhje edhe me rekomandimet e OSBE/ODIHR nr. 14 viti 2019 dhe nr. 18/19 viti 2021.

3) **Përdorimi i aseteve publike dhe fushata nga funksionarët publik**

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve aktualisht gjykon mbi raportimet e bëra nga vetë institucionet publike dhe nuk mund të monitorojë mediatizmin që iu bëhet veprimtarive me karakter publik. Kjo situatë e vendos në kushte mosveprimi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të identifikuar veprimtari me karakter publik për të cilat ka detyrim të raportohen, por ndërkohë mbeten të paraportuara.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është vendosur përpara situatave të paqarta në lidhje me pjesëmarrjen në fushatë apo veprimtari të tjera publike të kryetarëve të bashkive/ këshilltarëve bashkiakë, të cilët kanë edhe statusin e kandidatit.
- c. Neni 91, pika 4 i Kodit Zgjedhor, ndalon 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re, propozimin miratimin ose nxjerrjen e akteve ligjore ose nënligjore që parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të

popullsisë. Kjo dispozitë është e zbatueshme vetëm për zgjedhjet për Kuvend dhe është e paaplikueshme për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore.

Rekomandojmë:

Të përcaktohet në mënyrë shteruese (nëpërmjet përkufzimit/ve) çfarë duhet të jetë e ndaluar për funksionarët publik në kuadër të fushatës zgjedhore, si dhe mekanizmat për verifikimin nga KQZ mbi përdorimin e aseteve publike dhe veprimtarinë e institucioneve publike.

Propozimet për këtë aspekt vlerësoj se konsiderojnë edhe rekomandimin e OSBE/ODIHR nr.16 viti 2021

Është e qartë që në kuadër të rritjes së standardit të administrimit të procesit zgjedhor, të integritetit dhe të ndershmërisë së tij, ka edhe shumë çështje tjera të cilat duhet të adresohen, në përputhje me konstatimet dhe rekomandimet e Raportit Final të OSBE-ODIHR për zgjedhjet e 2019 dhe 2021.

Organet drejtuese të KQZ dhe anëtarësia kanë vlerësimet dhe rekomandimet përkatëse, të cilat nëse e vlerësoni jemi të gatshëm ti prezantojmë përpara jush.

Duke ju falenderuar,

Me respekt

Ilirjan CELIBASHI

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE